



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Kuvendi i Kryeqytetit  
Skupstina Glavnog Grada - Municipality of Prishtina



## E K S T R A K T

**i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 25.11.2022, duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë :** Mirsada Behluli, Elmira Nikçi Rexha, Arton Brahim, Trier Kasumi - Berisha, Nenad Miladinovic, Kimeta Shok, Oktay Kurtesh, Faton Marolli, Adnan Ajeti.

**Në mbledhje morën pjesë edhe :** Klaudia Mula, koordinatore për komunitete në ZKKK-në, Florent Salihu, përfaqësues nga UNMIK-u, Arianita Beqa - Rraci, përfaqësuese nga UNMIK-u, Nebahat Bejtullah, zyrtare nga DKA-ja, Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prishtinës, Betim Abdullahu, u.d. i udhëheqësit të ZKKK-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit për Komunitete Mirsada Behluli me këtë

### R E N D T Ë D I T Ë S:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Ftesë për Kryetarin e Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama, (për të na informuar lidhur me realizimin e projekteve për vitin 2022, në përgjithësi për shpenzimin e mjeteve buxhetore dhe për ndihmën e komuniteteve jo shumicë, me referencë të veçantë për familjet me nevojë sociale, si p.sh me dru zjarri, pako higjienike dhe ushqimore;
3. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, znj. Besianë Musmurati;
4. Raport i ZKKK-së, për muajin tetor 2022;
5. Formimi i Komisionit për hartimin e raportit të punës së KK-së, për vitin 2022 dhe Planin e punës së KK për vitin 2023 ;
6. Raportimi nga përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë për gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre;
7. Të ndryshme.

**Njëzëri u miratua rendi i ditës.**

**Pika e parë**

**Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së**

**Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Pika e dytë**

**Ftesë për Kryetarin e Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama, (për të na informuar lidhur me realizimin e projekteve për vitin 2022, në përgjithësi për shpenzimin e mjeteve buxhetore dhe për ndihmën e komuniteteve jo shumicë, me referencë të veçantë për familjet me nevojë sociale, si p.sh me dru zjarri, pako higjienike dhe ushqimore**

Për shkak të mungesës me arsye të Kryetarit të Kryeqytetit, kjo pikë e rendit të ditës mbetet për shqyrtim për njërën nga mbledhjet e radhës të Komitetit.

**Pika e tretë**

**Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, znj. Besianë Musmurati**

**Mirsada Behluli**, kryesuese të pranishmit i informoi se gjatë vizitës në shkollat ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve jo shumicë, në shkollën fillore "Naim Frashëri", kemi hasur në probleme të shumta duke u nisur nga materiali shkollor i pa përkthyer në gjuhën boshnjake, duke u nisur nga librat në gjuhën boshnjake, ligjërimit i mësimdhënësve pa material të përkthyer, ditari digjital (e - shkollori), mungesa e kuadrit të mësimdhënësve në gjuhën boshnjake etj.

**Besianë Musmurati**, drejtore tha se në bazë të raporteve kemi 312 nxënës të komuniteteve jo shumicë, ku prej tyre janë 12 në shkollën fillore "Naim Frashëri", dhe 8 në shkollën e mesme të mjekësisë "Ali Sokoli", janë të komunitetit boshnjak, kështu që po flasim për një numër goxha të limituar, por unë e kryesoj edhe kolegjiunin e drejtorëve të DKA-ve, në nivel të vendit.

Ajo në vazhdim tha se disa prej shqetësimeve që ju i keni ngritur i kam dëgjuar edhe prej komunave të tjera, ku shumica e problemeve kanë të bëjnë me problemet shkollore në gjuhën boshnjake si dhe plan programet në gjuhën boshnjake. Për veç kësaj problem tjetër kemi edhe dështimin e konkurseve për punësimin e mësimdhënësve në gjuhën boshnjake në të gjitha komunat e Kosovës, kjo është krejt pasi që Universiteti i Prishtinës, nuk ka drejtim të specializuar në gjuhën boshnjake.

Ajo mes tjerash tha se krejt çka mundemi me bërë është që në nivel të komunave së bashku me Universitetin e Prishtinës, me e ngrit që me e hapur një numër të caktuar të konkurseve në UP për ata që dunë të studiojnë në fakultetin e Edukimit në gjuhën boshnjake, por kjo nuk është që ne mundemi me pasur nën kontroll të Komunës, mirëpo mundemi me pasur rol pozitiv.

**Triera Kosumi - Berisha**, lidhur me diskutimin e bërë tha se Republika e Kosovës në kushtetutën e saj e ka goxha njëfarë hapësire të barabartë për krejt komunitetet që jetojnë në territorin e Kosovës, ndërsa sa i përket shkollave drejtoreshë si anëtare e këtij Komisioni kam dal shumë e gëzuar prej disa të gjeturave e goxha e lumtur prej të gjeturave të tjera gjatë vizitës.

Ajo mes tjerash tha se e di shumë mirë që drejtorja nuk ka kompetencë, mirëpo ju kisha lutur që ky komitet së bashku me juve me e bërë një nismë që kjo mos me u bërë çështje politike por me u bërë çështje esenciale dhe e rëndësishme ashtu siç është si dhe të parandalohet braktisja e shkollës nga ata nxënës, sepse edhe ata janë fëmijë të Republikës së Kosovës.

**Besianë Musmurati**, drejtoreshë lidhur me çështjen e braktisjes së shkollës tha se ne në DKA e kemi ekipin për braktisje i cili ende nuk ka filluar me punuar dhe mendoj që edhe ata kanë ende mundësi me u përmirësuar .

Mirëpo ekziston si ekip brenda që e ka për qëllim me i detektuar këto rastet e më hershme, sa më herët që i detektojmë aq më shumë me punuar me ta që me e parë se çka mundemi me ju ndihmuar që mos me shkua deri tek braktisja.

Ajo në vazhdim tha se është shumë mirë që i keni identifikuar dhe tani me i përcjell tek ne, si dhe nëse kishit pasur mundësi me kontaktuar me arsimtarët aty dhe me e parë se çka ju mungon pra duke u nisur nga përkthimi i librave shkollor edhe në gjuhën boshnjake, edhe në gjuhën turke.

**Kimeta Shok**, shtroi pyetje se a është ndërmarr diçka për rregullimin e tavaneve që për shkak të reshurave rrjedh uji në tavanet në 2-3 klasa në shkollën fillore "Xhevdet Doda", dhe nxënësit nuk kanë kushte për të mbajtur mësimin.

**Besianë Musmurati**, drejtoreshë lidhur me pyetjen e shtruar nga znj. Shok tha se veç ka filluar rregullimi i klasave, dhe i banjove, ku edhe besoj se me menaxhmentin e ri të shkollës kemi me e rregulluar që kerret me u hekë prej aty edhe oborri me u revitalizuar për me qenë më i përshtatshëm.

**Nenad Miladinovic**, shtroi pyetje për drejtoreshën se a është realizuar apo bërë diçka rreth faturës për rrymë të cilën e kam sjellë para katër ditëve në drejtori, që mos të ndalet rryma në shkollë.

**Besianë Musmurati**, drejtoreshë tha se ne si Drejtorin e Arsimit, i kemi drejtuar të gjitha në Drejtorin e Financave.

Ajo në vazhdim tha se një problem që ekziston është se realizimi i këtyre pagesave duhet me pasur një mbulueshmëri ligjore ku e bëjmë një lloj memorandum bashkë që nëse ne vazhdojmë me e paguar rrymën atëherë pagesa e faturës duhet me qenë e bazuar diku.

Pra pse po ndodhin këto ndalesa arsyeja është se edhe nëpër shkollat tona po ka shumë probleme, për shkak se KEDS-i, tash është bërë më rigoroz, kështu që ne i kemi përcjellë të gjitha faturat e juaja atje dhe jemi duke pritur prej Zyrës së Financave, që me i ekzekutuar.

**Nenad Miladinovic**, tha se faturat për rrymë dhe ujë janë paguar gjatë gjithë kohës, ndërsa ajo faturë është që nuk është paguar për një periudhë të caktuar, ndërsa arsyeja e mos pagesës së asaj fature sa unë jam i informuar është se dikush atje ka deklaruar kinse shkolla nuk funksionon.

Pra nëse kjo është arsyeja dua të më tregoni konkretisht se a do të paguhet ajo faturë apo të gjejmë ndonjë mënyrë tjetër që mos të vjen deri tek ndërprerja e rrymës.

**Besianë Musmurati**, drejtore tha se kjo është çështje me të cilën merret Zyra ligjore dhe ajo e financave, pasi që problemi është se janë grumbulluar shumë fatura.

**Oktay Kurtesh**, ngriti shqetësimin lidhur me çerdhet ku tha se tek çerdhja "Gëzimi Ynë", i kemi dy çerdhe për komunitetin turk, ku aty fëmijët e komunitetit turk shkojnë vetëm deri në moshën tri vjeçare, prandaj shtroi pyetje se a ka mundësi që ata fëmijë të vazhdojnë edhe pas moshës tri vjeçare përmes shtimit të stafit për fëmijët pas moshës tri vjeçare.

**Besianë Musmurati**, drejtore tha se është fakt se në çerdhe ekziston problemi, mirëpo problemi më i madh është se ne në çerdhe nuk kemi të drejtë me e rritur asnjë staf, pra unë nuk mundem me marr asnjë edukatore të re qoftë e komunitetit shqiptar apo të komunitetit tjetër. Problemi është që numri është tepër i limituar, ku për këtë arsye Komuna e Prishtinës e ka bërë çerdhen me bazë në komunitet është dashur me zbuluar model krejt tjetër që me pas mundësi me punësuar staf shtesë.

Ne po ndërtojmë çerdhe konstant, por stafi nuk ka mundur me u shtuar asnjëherë.

**Mirsada Behluli**, kryesuese falënderoi drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit znj. Besianë Musmurati, me shpresë se kërkesat e dala nga ky komitet do të realizohen sipas mundësive.

#### **Pika e katërt**

#### **Raporti i ZKKK-së, për muajin tetor 2022**

**Betim Abdullahu**, sa i përket Raportit të ZKKK-së, në pika të shkurta i njoftoi të pranishmit lidhur me aktivitetet të cilat janë bërë gjatë muajit tetor nga ana e grupit punues duke u nisur nga vizita në shkolla ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve jo shumicë. Hartimi i planit të punës së ZKKK-së, për vitin 2023 - 2025, dërgimi i rekomandimeve dhe komplet lista për dru zjarri, kemi marr pjesë edhe në aktivitete të tjera që i kemi të planifikuara me plan të punës dhe plan vjetor, aktivitetet me organizatat ndërkombëtare etj.

**Nenad Miladinovic**, lidhur me raportin e ZKKK-së, për muajin tetor 2023 tha se kryesisht ka të bëjë me arsimin pra raportimin nga vizita në shkolla.

Ai në vazhdim tha se ajo çka më intereson më shumë është se kanë qenë dy kërkesa për rikthim në Komunën e Prishtinës, se çka është bërë me to, ku njëra ka të bëjë me z. Zharko Gajic i cili me ka kontaktuar për të ditur se çka është bërë me lëndën e tij.

**Betim Abdullahu**, tha se sa i përket aktiviteteve të ZKKK-së, çdo herë ndoshta bëjmë më shumë aktivitete me organizatat ndërkombëtare se që janë të planifikuara.

Ndërsa sa i përket rasti të z. Zharko Gajic tha se janë mbajtur dy takime për kthim, ku në takimin e parë i kemi kërkuar dokumente shtesë të cilat i kanë munguar, por i njëjti nuk i ka sjell. I kemi shkruar edhe email zyrtar, ku pasi ka pranuar emailin zyrtar ka dërguar një përfaqësues të vetin i cili na ka thënë se shumë shpejt do ju sjellim dokumentet, ku ne e kemi pritur edhe dhjetë ditë të tjera.

E kemi mbajtur edhe takimin e dytë, mirëpo i lartë përmenduri z. Gajic as pas dy kërkesave tona nuk i ka plotësuar kërkesat që rekomandohen me ligj për secilin person të zhvendosur.

#### **Pika e pestë**

**Formimi i komisionit për hartimin e raportit vjetor të punës 2022, si dhe hartimin e planit të punës për vitin 2023, të Komitetit për Komunitete**

**Mirsada Behluli**, kryesuese për anëtarë të Komisionit për hartimin e raportit vjetor të punës për vitin 2022 të Komitetit për Komunitete, propozoi Faton Marolli, Tria Kasumi dhe Klaudia Mula, ndërsa për anëtarë të Komisionit për hartimin e planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023 propozoi Nenad Miladinovic, Klaudia Mula, Kimeta Shok dhe vet Mirsada Behluli.

Njëzëri u miratuan të dy propozimet nga ana e znj. Behluli.

#### **Pika e gjashtë**

**Raportimi nga përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë për gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

#### **Pika e shtatë**

**Të ndryshme**

Nuk pati diskutime.

*Mbledhja mbaroi në orën 12:30*

**Procesmbajtësja**  
**Lendita Spahija**

**Kryesuesja e Komitetit**  
**Dr. Mirsada Behluli**

